V E N D I M
Nr. 387, datë 8.8.2002

PËR DHËNIE FONDI NDIHMË PARTIVE POLITIKE TË REJA

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të nenit 18 të ligjit nr.8580, datë 17.2.2000 "Për partitë politike", me propozimin e Ministrit të Financave, Këshilli i Ministrave

V E N D O S I:

Dhënien e një fondi, si ndihmë financiare, partive politike të reja, si më poshtë vijon:
- Partisë Kristian-Demokrate të Shqipërisë 100 000 (njëqind mijë) lekë.
- Partisë Aleanca Socialiste e Shqipërisë 100 000 (njëqind mijë) lekë.
2. Ky fond të përballohet nga fondet buxhetore të vitit 2002 për partitë politike.
Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Fatos Nano